

VENDIM
Nr.889, datë 22.12.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” dhe “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar të bëhen këto ndryshime:

a) Tabelat nr.2 “Pasqyra e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit në qendër” dhe “Pasqyra e pagave për punonjësit e degëve të Policisë së Ndërtimit në rrethe” zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

b) Niveli më i ulët i pagës (Klasa I), për punonjësit e Policisë së Ndërtimit, bëhet 10 800 (dhjetë mijë e tetëqind) lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (Kryetar dege / Klasa XXII) bëhet 28 000 (njëzet e tetë mijë) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për këtë vit, për paga e sigurime shoqërore, për Policinë e Ndërtimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Tabela Nr. 2

**PASQYRA E PAGAVE PER PUNONJESIT E DREJTORISE SE
POLICISE SE NDERTIMIT NE QENDER**

Nr.	EMERTIMI	KLASA	PAGA NE LEKE
1.	Drejtor		74345
2.	Zevendesdrejtor		55422
3.	Kryetar Dege	XXII	28000
4.	Shef Sektori	XXII	28000
5.	Kryetar Grupi Gadishmerie	XXII	28000
6.	Specialiste	XXI	26000
7.	Shofer	IX	15800
8.	Punonjes Grupi Gadishmerie	XIX	21800
9.	Arkivist. Dkatilografist. Protokollist	VI	13900
10.	Magaznier	VI	13900
11.	Sekretare, daktilografiste.	VI	13900
12.	Punonjes Sherbimi	III	12500
13.	Pastruese	I	10800

Tabela Nr. 2

**PASQYRA E PAGAVE PER PUNONJESIT E DREJTORISE SE
POLICISE SE NDERTIMIT NE RRETHE**

Nr.	EMERTIMI	KLASA	PAGA NE LEKE
1.	Kryetar Dege K1	XXII	28000
2.	Kryetar Dege K2	XXI	26000
3.	Shef Sektori	XXI	26000
4.	Specialist i larte	XX	23500
5.	Specialsit i mesem	VIII	14500
6.	Kryetar Grupi Gadishmerie	XXI	26000
7.	Specialist Grupi Gadishmerie	XIX	21800
8.	Arkivist - Protokollist	VI	13900
9.	Shofer	IX	15800